

Kuiz Olimpik

Kohëzgjatja: 20 minuta

Grupi i synuar: Të rinjtë 12-13 vjeç

Lideri i aktivitetit: 1

Përgatitje (lideri i aktivitetit)

Familjarizohuni me pyetjet

Përshkrimi

Dhjetë pyetje për të testuar njohuritë Olimpike e pjesëmarrësve.
E vërtetë apo e gabuar? Kush do të jetë i pari për të gjetur përgjigjen ?

Udhëzime

- Ndani fëmijët në dy grupe, shpjegojini atyre se, ata do të duhet të mendojnë nëse informacioni që do të lexojnë është i vërtetë apo i gabuar. Lexo pikat nga 1 deri në 10, duke lënë disa minuta për secilin grup për të rënë dakord për përgjigjet (" e vërtetë " ose " e gabuar "), duke e shënuar këtë në një copë letër së bashku me numrin e pyetjes.
- Kur të keni mbaruar, shikoni çdo pyetje, duke i kërkuar çdo grupi përgjigjet. Jepni përgjigjen e saktë dhe shpjegimin për të (ose pyesni nëse dikush e di përgjigjen). Në vartësi të moshës dhe kohës në dispozicion, filloni një diskutim mbi temat e pyetjeve.
- Grupi i cili i jep më shumë përgjigje të sakta është fitues.

Ju sigurisht mund të përdorni kuizet për aktivitete të tjera, ose në mënyrë tjetër (p.sh. përgjigje individuale, kërkonte për përgjigjet e duhura në internet, etj).

1.

Çdo ngjyrë e Rrathëve Olimpik përfaqëson një Kontinent

E gabuar

Ky është një keqkuptim, pasi në të vërtetë, rrathët përfaqësojnë bashkimin e pesë Kontinenteve dhe grumbullimin e sportistëve nga e gjithë bota në Lojërat Olimpike. Sa për ngjyrat e flamurit, ata janë zgjedhur për shkak se të paktën njëra prej tyre (blu, e zezë, e kuqe, e verdhë, e gjelbër dhe e bardhë) mund të gjendet në çdo flamur kombëtar.

2.

Një nga misionet e Lëvizjes Olimpike është që të promovojë paqen në botë

E vërtetë

"Qëllimi i Olimpizmit është vendosja e sportit në shërbim të harmonizimit tek njerëzit, me qëllim promovimin e një shoqërie paqësore dhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor".
Ky është parimi i dytë nga gjashtë parimet themelore të Olimpizmit të përcaktuara në "Kartën Olimpikë", dokument ky i cili rregullon organizimin, veprimtarinë dhe funksionimin e Lëvizjes Olimpike.

3.

Qyteti ku do të zhvillohen Lojërat Olimpike zgjidhet me shorte midis qyteteve kandidate

E gabuar

Anëtarët e CIO zgjedhin qytetin e Lojërave Olimpike me një shumicë absolute votash (dmth, gjysma e votave plus një). Kjo vendoset shtatë vjet para se të mbahen Lojërat, përgjatë një takimi të quajtur Sesion. Sipas traditës Presidenti nuk merr pjesë në votim.

4.

Himni Olimpik është shkruar nga Rod Stjuart, këngëtar i viteve 1980

E gabuar

Muzika u kompozua nga Spiros Samaras dhe teksti është shkruar nga Kostis Palamas. Himni Olimpik u luajt për herë të parë në 1896, në ceremoninë e hapjes së Lojërave të para Olimpikë moderne. Ai u zëvendësua më vonë me disa kompozime të tjera muzikore (por asnjë nga Rod Stjuard). Vetëm në vitin 1955 u bë Himni zyrtar i Lojërave Olimpikë.

5.

Motoja Olimpikë – CITIUS – ALTIUS - FORTIUS - do të thotë " Krenar, i gjatë, i fortë ".

E gabuar

Këto tri fjalë latine do të thonë" më shpejt, më lart, më fort". Këto fjalë inkurajojnë sportistët për të dhënë më të mirën nga vetja e tyre gjatë garimit. Për të kuptuar më mirë moton, ne mund të krahasojmë atë me thënien Olimpikë : " Gjëja më e rëndësishme në jetë nuk është fitorja por pjesmarrja".

6.

Hokey në akull dhe patinazhi artistik ishin në programin e Lojrave Olimpikë .

As e vërtetë as e gabuar

Patinazhi ishte në programin e Lojrave Olimpikë te vitit 1908 dhe hokey në akull në vitin 1920. Në atë kohë, nuk kishte asnjë dallim midis Lojrave Dimërore dhe Lojrave Verore dhe aktivitet mund të zgjasnin disa muaj. Në 1925 CIO vendosi zyrtarisht për t'i ndarë këto dy ngjarje, pra Lojërat Olimpikë Verore dhe Lojërat Olimpikë Verore.

7.

Themeluesi i Lojrave Moderne Olimpikë Pierre de Coubertin morri pjesë në Lojëra me një emër të rremë.

E vërtetë

Në konkursin "Bejta për Sportin", një konkurs për artin dhe letërsinë që zhvillohej në atë kohë, ai morri pjesë me një pseudonim në Lojërat Olimpikë të Stokholmit në vitin 1912 , dhe fitoi çmimin e parë.

8.

Ngritja e nje guri 50 kg ka qenë pjesë e programit Olimpik.

E vërtetë

Ajo ishte pjesë e garës gjimnastikore e vitit 1900, siç ishte dhe ngjitja me litar dhe kërcimi me shkop. Sportet, disiplinat dhe garat e përfshira në programin e Lojrave Olimpikë ndryshojmë vazhdimisht. Sot, Lojërat Verore përbëhen nga 26 disiplina sportive dhe Lojërat Dimërore nga shtatë. Në kriteret e përzgjedhjes është specifikuar se vetëm sportet që aplikojnë Kodin Botërorë të Anti-Doping mund të përfshihen ose të jenë pjesë në program.

9.

Londra është i vetmi qytet ku janë zhvilluar Lojërat Olimpikë tre herë.

E vërtetë

Londra ka qënë qyteti mikpritës i Lojrave Olimpikë në vitin 1908, 1948 dhe 2012. Në gjashtë qytete të tjera ato janë zhvilluar dy herë, Athinë (1896 dhe 2004), Paris (1900 dhe 1924), St Moritz (1928 dhe 1948), Lake Placid (1932 dhe 1980), Los Angeles (1932 dhe 1984) dhe Innsbruck (1964 dhe 1976).

10.

Maratona ka qënë në programin e Lojrave Olimpikë që prej Antikitit.

E gabuar

Maratona nuk ka qënë pjesë e Lojrave Olimpikë në antikitet. Kjo garë u krijua për Lojërat Olimpikë të para Moderne të zhvilluar në Athinë në vitin 1896, për nder të një ushtari grek i cili në 490 p.e.s. vrapoi nga një vend i quajtur Maraton deri në Athinë (në distancë : rreth 34.5 km) për të lajmëruar popullin për fitoren kundër persëve. Në Lojërat Olimpikë të Londrës të zhvilluara në vitin 1908, distanca e garës ndryshoi nga 25 në 26.2 milje (42.195 km), në mënyrë që ajo mund të përfundojë para Royal Box (Froni i Mbretit) . Kjo distancë më pas u bë standard për maratonat e ardhëshme.